



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1092/ Prot.

Gjirokastrë, më 08 / 09 / 2020

## STATUTI I KËSHILLIT STUDENTOR

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

KËSHILLI STUDENTOR

(Miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08 / 09 / 2020, të Senatit Akademik të UGJ-së)



## **Neni 1**

### **Baza ligjore**

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë“ neni 98 e 99, Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” neni 54 dhe Rregullorja e Universitetit “Eqrem Çabej”.

## **Neni 2**

### **Akronime**

Për qëllime të këtij Statuti:

1. “UGJ” është akronim i emrit Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë;
2. “KS” është akronim i emrit Këshill Studentor;
3. “KSF” është akronim i emrit Këshilli Studentor i Fakultetit;
4. “KSUGJ” është akronim i emrit Këshilli Studentor i Universitetit “Eqrem Cabej”;
5. “SS” është akronim i emrit Senati Studentor;
6. “KKS” është akronim i emrit Këshilli Kombëtar Studentor;
7. “Senator Studentor” është student i zgjedhur në SS;

## **Neni 3**

### **Emërtimi**

Emërtimi i organizmit është “Këshilli Studentor i Universitetit të Gjirokastrës” (KSUGJ).

## **Neni 4**


### **Zyra e KSUGJ**

Zyra e KSUGJ-së ndodhet në ambjentet e Fakultetit Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Zyra dhe pajisjet që ndodhen në të administrohen nga kryetari.

## **Neni 5**

### **Statusi**

KSUGJ është organizatë e pavarur e studentëve, e themeluar nga studentët e universitetit “Eqrem Çabej”. Përbëhet nga studentë të zgjedhur me votim sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e zgjedhjeve. Nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe kordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UGJ, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore, institucioni, si edhe në nivel kombëtar.



## **Neni 6**

### **Stema**

Stema e “Këshillit Studentor të Universitetit të Gjirokastrës”(KSUGJ) është në formë rrethore dhe në mes ndodhet logo e saj e cila është e njëjtë me logot e të gjithë këshillave studentore të fakulteteve të Universitetit Eqrem Çabej-Gjirokastrë.

1. Në pjesën e sipërme të stemës shkruhet: Universiteti i Gjirokastrës
2. Në pjesën e poshtme shkruhet: Këshilli Studentor.
3. Stema e KSUGJ ndodhet në fund të këtij statuti.

## **Neni 7**

### **Anëtarësia e KSUGJ**

Anëtar i KSUGJ mund të jetë secili student i UGJ

## **Neni 8**

### **Qëllimi**

Qëllimi i KSUGJ është mirëorganizimi i jetës studentore në bazë rregullash të qarta, për të arritur rezultate sa më të larta, për të rritur cilësinë e mësimnxënies, për të ndihmuar studentët që kanë nevojë, për të nxitur frymën e bashkëpunimit me personelin akademik, për të nxitur punën kërkimore shkencore të studentët, për të përfaqësuar KSUGJ sa më denjësisht në rankimimet e të njëjtit nivel, për ballafaqime të ndryshme cilësore në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e emrit dhe të vlerave të UGJ.

## **Neni 9**

### **Objektivat**

1. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për: planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore e kërkimore shkencore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive .
2. Ndërgjegjësimi i studentëve lidhur me edukimin dhe ndërtimin e karrierës.
3. Organizimi i jetës kulturore, sportive e sociale nga vetë studentët.
4. Krijimi i klubeve dhe shoqërive studentore në përputhje me qëllimet e KS.
5. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen universitare.
6. Bashkëpunimi në mënyrë aktive me KS të Institucioneve tjera Universitare.
7. Të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre;
8. Të kontribuojë në rritjen e aftësive organizuese dhe administruese të të studentëve;
9. Të krijojë shërbime lehtësuese për studentët;

## **Neni 10** **Pavarësia Politike**

KSUGJ-ja është një organizëm jo politik, të cilit i ndalohet çdo lloj bashkëpunimi me parti dhe organizata politike, si dhe prononcimi politik publik, në emër të Këshillit Studentor të UGJ-së apo strukturave të tij.

## **Neni 11** **Anëtarësimi i KSUGJ**

KSUGJ ka të drejtë të antarësohet në organizata jopolitike brenda institucioneve të arsimit të lartë. Vendimi për anëtarësim merret nga Senati Studentor i KSUGJ. KSUGJ është anëtar me të drejta të plota në Këshillin Kombëtar Studentor (KKS). Përfaqësues i KSUGJ në KKS është kryetari i KSUGJ.

## **Neni 12** **Të drejtat dhe detyrat e studenteve ne marrëdhënie me KSUGJ**

1. Çdo student ka të drejtë të informohet mbi veprimtarinë e KSUGJ
2. Çdo student ka për detyrë të zbatojë me rigorozitet statutin e KSUGJ.
3. Të respektojnë Kodin e Etikës së institucionit (referuar kodit të etikës në paragrafin për studentet);
4. Të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;

## **Neni 13** **Organet e KSUGJ**

Organet e KSUGJ janë:

1. Senati Studentor
2. Këshilli Studentor i Fakulteteve
3. Kryesia e KSUGJ

## **Neni 14** **Senati Studentor**

1. Organi më i lartë kolegjal vendimmarrës i KSUGJ është Senati Studentor (SS). Antaret e SS quhen senator dhe zgjidhen çdo 2 vjet nga komuniteti studentor i Fakulteteve të UGJ.
2. Mbledhjet e SS drejtohen nga kryetari i SS.



3. SS thirret në mbledhje të zakonshme, por mund të thirret edhe në mbledhje të jashtëzakonshme nga kryetari ose nga 1/3 e anëtarëve të SS.
4. SS përbëhet nga 19 anëtarë si vijon:
  - a. 5 (pesë) përfaqësues të FESHSH;
  - b. 5 (pesë) përfaqësues të FSHN
  - c. 5 (pesë) përfaqësues të FE
  - d. 3 (tre) kryetarët e KSF
  - e. 1 (një) kryetari KSUGJ
5. SS si rregull mblidhet një here në muaj. Mbledhejt e SS janë të vlefshme kur janë njoftuar të gjithë senatorët, pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve në mbledhje. Mbledhjet e SS drejtohen nga kryetari i KSUGJ. Vendimet e SS merren vetëm kur në mbledhje ka kuorum. Përveç rasteve që statuti parashikon ndryshe, vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të senatorëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta vota e kryetarit konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve. Vendimi për shkarkimin e kryetarit, zv/kryetarit, sekretarit të përgjithshëm apo senatorit të KSUGJ merret me votim të fshehtë, me 3/5 e votave të të gjithë senatorëve. Vendimet e SS, pasi firmosen dhe vulosen nga kryetari, hyjnë në fuqi menjëherë.
6. SS ka këto kompetenca:
  - a. Miraton paraprakisht Statutin e Këshillit Studentor dhe e përcjell në Senatin Akademik për Miratim;
  - b. Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të KSUGJ;
  - c. Merr vendime në përputhje me kompetencat dhe të bazuara në aktet ligjore e nënligjore dhe me këtë statut;
  - d. Diskuton dhe vendimon për problemet me interes të përgjithshëm të UGJ: për programet e studimeve; rregulloret për veprimtaritë mësimore; cilësinë e shërbimeve; tarifat e shkollimit dhe kontributet të tjera financiare për studentët; zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.;
  - e. Miraton projekt programin vjetor të aktiviteteve;
  - f. Zgjedh ose shkarkon kryetarin, zv/kryetarin, sekretarin e përgjithshëm të KSUGJ me votim të fshehtë;
  - g. Mandaton kryetarin e KSUGJ;
  - h. Shkarkon senatorin me votim të fshehtë;
  - i. Krijon komisione të përhershme ose të përkohshme për çështje të ndryshme dhe përcakton mënyrën e funksionimit të tyre;
  - j. Vendos për krijimin e marrdhenieve me klubet studentore me synimin bashkëpunimin dhe ndihmen e ndërsjelltë;
  - k. Shpall datën e fillimit të fushatës elektorale, datën e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme ose të pjesshme, sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e zgjedhjeve për KSUGJ;

### Neni 15



## **Këshilli studentor i fakultetit (KSF)**

1. KSF-ja është organi më i lartë i zgjedhur studentor në rang Fakulteti;
2. Përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të programeve të studimit, të shpërndarë proporcionalisht me numrin e studentëve, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të KSF-së.
3. KSF-ja kryesohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga trupa studentore e fakultetit përkatës.

### **Neni 16**

#### **Kryesia e KSUGJ**

Kryesia e KSUGJ përbëhet nga:

- a. Kryetari i KSUGJ
- b. Nënkryetari/ët i/e KSUGJ
- c. Sekretari i përgjithshëm i KSUGJ

### **Neni 17**

#### **Kryetari i KSUGJ**

1. Kryetari duhet të jetë senator i KSUGJ;
2. Zgjidhet nga trupa zgjedhore e studentëve të të gjitha njësive kryesore;
3. Ka mandat dy vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e kryetarit të ri;
4. Kryetari ka këto kompetenca:
  - a. Drejton veprimtarinë e KSUGJ në bazë të statutit;
  - b. Hyn në marrdhënie me organizma, organizata apo institucione të tjera pas vendimit të marrë nga SS;
  - c. Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e SS;
  - d. Përcakton rendin e ditës së mbledhjes së SS;
  - e. Përgatit, thërret dhe drejton mbledhje të jashtëzakonshme të SS;
  - f. Kujdeset, përfaqëson dhe mbron interesat e KSUGJ në marrdhënie me të tretët;
  - g. Bën deklarime publike për të shprehur qëndrimin zyrtar të KSUGJ mbi çështje të ndryshme;
  - h. Delegon tërësisht ose pjesërisht kompetencat e tij tek zv/kryetari;
  - i. Mban vulen e KSUGJ dhe firmos dhe vulos cdo vendim apo shkresë në emër të SS;
  - j. Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe e paraqet për miratim në SS;
  - k. Merr në shqyrtim propozimet që bëhen nga institucione dhe organizma të ndryshme me qëllim bashkëpunimie të ndërsjelltë dhe i paraqet ato në SS;
  - l. Monitoron zbatimin e vendimeve të SS;



- m. Autorizon persona josenatorë të marrin pjesë në mbledhjen për të prezantuar tematika sipas kompetencave që zotërojnë;

### **Neni 18**

#### **Zv/kryetari i KSUGJ**

1. KSUGJ ka dy zv/kryetarë;
2. Zv/kryetari i KSUGJ mund të jetë çdo student i universitetit. Ai propozohet nga kryetari dhe zgjidhet nga SS;
3. Ka mandat dy vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen e zv/kryetarit të ri;
4. Kompetencat e zv/kryetarit janë:
  - a. Merr pjesërisht ose tërësisht kompetencat e kryetarit me deklaram të shkruar të këtij të fundit;
  - b. Në rastet kur kryetari humbet mandatin si senator, shkarkohet ose jep dorëheqjen zv/kryetari me i madh në moshë merr tërësisht kompetencat e kryetarit (përveç të drejtës së votes në SS kur nuk është senator), deri në zgjedhjen dhe mandatimin e kryetarit të ri.

### **Neni 19**

#### **Sekretari i Përgjithshëm**

1. Sekretari i përgjithshëm i KSUGJ zgjidhet çdo dy vjet nga SS dhe është anëtar pa të drejtë vote i SS në rast se nuk është senator;
2. Ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen e sekretarit të ri të përgjithshëm;
3. Kompetencat e sekretarit të përgjithshëm janë:
  - a. Njofton publikisht senatorët për mbledhjet e SS dhe aktivitetet e tjera të KSUGJ;
  - b. Administron gjithë dokumentacionin original të KSUGJ: tabelat e rezultateve të zgjedhjeve, mungesat e senatorëve në mbledhjet e SS, bazën e të dhënave të KSUGJ, vendimet e SS, statutin e KSUGJ etj.;
  - c. Mban protokollin për të gjithë korrespondencën e KSUGJ me organizma dhe institucione të tjerë.

### **Neni 20**

#### **Senatori**

1. Senatori zgjidhet ç' do dy vite nga zona e tij elektorale dhe ka këto kompetenca:
  - a. Të marrë pjesë me të drejtë vote në të gjitha mbledhjet SS;
  - b. Të ketë prioritet në aktivitetet që mundësohen nga KSUGJ dhe nga organizata apo institucione partnere;
  - c. Të diskutojë në emër të studentëve të zones së tij elektorale dhe të përfaqësojë vullnetin e tij para SS, stafit akademik dhe joakademik të universitetit;
  - d. Të organizojë të paktën një here në muaj diskutime me studentët e zones së tij elektorale dhe të zbatojë vullnetin e tyre;



- e. Të kandidojë për postin e kryetarit dhe çdo funksion tjetër në KSUGJ;
- f. Të informojë studentët e zones së tij elektorale mbi aktivitetet që realizohen nga KSUGJ apo organizata dhe institucione partnere;
- g. Të paraqesë me shkrim në SS, të paktën një here në dy muaj, një raport mbi shqetësimet dhe sugjerimet e studentëve të zones së tij elektorale;
- h. Kur senatori humbet mandatin e tij për arsye të parashikuara në statut zëvendësohet deri në zgjedhjet e ardhëshme nga kandidati për senator që është renditur i dyti për nga votat e marra në zgjedhjet e fundit.

### **Neni 21**

#### **Administrimi financiar i këshillit studentor të UGJ**

1. Llogaria bankare e Këshillit Studentor është ajo e UGJ me shtesën / Këshilli Studentor;
2. Veprimet me llogari bankare të KSUGJ kryhen vetëm nga administratori i universitetit konform ligjeve në fuqi, statutit të KSUGJ, vendimeve të KSUGJ dhe kontratave të KSUGJ me pale të tjera;
3. Buxheti i KSUGJ është zë më vete në buxhetin e universitetit;
4. Burimet financiare të KSUGJ janë:
  - a. Buxheti vjetor i akorduar nga universiteti;
  - b. Të ardhurat prej aktiviteteve të organizuara nga KSUGJ;
  - c. Donacionet e ndryshme;
  - d. Nga çdo mënyrë tjetër ligjore me përjashtim të sponsorizimeve dhe dhurimeve nga parti apo organizata politike.

### **Neni 22**

#### **Mandatimi**

1. Mandatimi i senatorit kryhet nga Komisioni i Zgjedhjeve.;
2. Mandatimi i kryetarit të KSUGJ kryhet nga Senati Studentor;
3. Mandatimi i zv/kryetarit, sekretarit të përgjithshëm kryhet nga kryetari i KSUGJ.

### **Neni 23**

#### **E drejta e kandidimit ose propozimit për në kryesinë e KSUGJ**

1. Të drejtën e kandidimit për kryetar e ka çdo senator i KSUGJ;
2. Të drejtën për t'u propozuar si zv/kryetar nga ana e kryetarit të KSUGJ e ka çdo student i UGJ;
3. Të drejtën për tu propozuar si sekretar i përgjithshëm nga ana e kryetarit të KSUGJ e ka çdo student i UGJ





**Neni 24**  
**Shkarkimi i kryetarit**

1. Propozimi për shkarkimin e kryetarit mund të bëhet nga:
  - a. 1/3 e të gjithë studentëve të UGJ;
  - b. 1/3 e të gjithë senatorëve;
2. Kryetari mund të shkarkohet kur pro shkarkimit votohet nga 3/5 e të gjithë senatorëve;
3. Vendimi për shkarkimin e kryetarit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga senatorët.
4. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

**Neni 25**  
**Shkarkimi i zv/kryetarit**

1. Propozimi për shkarkimin e zv/kryetarit mund të bëhet nga:
  - a. 1/3 e të gjithë senatorëve
  - b. Kryetari.
2. Zv.kryetari mund të shkarkohet kur pro shkarkimit votohet nga 3/5 të të gjithë senatorëve.
3. Vendimi për shkarkimin e zv.kryetarit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga senatorët.
4. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

**Neni 26**  
**Shkarkimi i sekretarit të përgjithshëm**

1. Propozimi për shkarkimin e sekretarit të përgjithshëm mund të bëhet nga :
  - a. 1/3 e të gjithë senatorëve;
  - b. Kryetari
2. Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet kur pro shkarkimit votohet nga 3/5 të të gjithë senatorëve;
3. Vendimi për shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga senatorët.
4. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

**Neni 27**  
**Shkarkimi i senatorit**



1. Propozimi për shkarkimin e senatorit mund të bëhet nga:
  - a. 1/5 e studentëve të zones së tij elektorale;
  - b. 1/3 e të gjithë senatorëve;
  - c. Kryetari.
2. Senatori mund të shkarkohet kur pro shkarkimit votohet nga 3/5 të të gjithë senatorëve studentorë.
3. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

### **Neni 28**

#### **Humbja e mandatit të senatorit**

1. Senatori e humbet mandatin kur:
  - a. Kryen më shumë se 5 mungesa të pajustificuara në mbledhjet e SS;
  - b. Shkarkohet;
  - c. Jep dorëheqjen;
  - d. Merr tre vërejtje nga kryetari për veprimtari në kundërshtim me statutin dhe interesat e KSUGJ.
  - e. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

### **Neni 29**

#### **Rregullorja e brendshme e KSUGJ**

Në funksion të mirëfunksionimit të veprimtarisë së KSUGJ, Senati Studentor harton dhe miraton një rregullore të brendshme, në përputhje me statutin e KSUGJ. Rregullorja mund të parashikojë në mënyrë të detajuar gjithë funksionimin e organeve të KSUGJ, organizimin e zgjedhjeve etj.

### **Neni 30**

#### **Zgjedhjet**

Administrimi i zgjedhjeve, zgjedhsit dhe listat e zgjedhsve, regjistrimi i kandidatëve dhe fushata zgjedhore, infrastruktura dhe dokumentacioni zgjedhor, votimi etj., përcaktohen në rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për këshillin studentor.

### **Neni 31**

#### **Ndryshimet e Statutit**



Statuti mund të ndryshohet nga SS me jo më pak se dy të tretat e anëtarëve.

**Neni 32**  
**Dispozita kalimtare**

Në rastet kur një individ izgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.

**Neni 33**  
**Hyrja në fuqi**

Ky statut hyn në fuqi menjëherë.

